



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 5/8 Prot

Vlorë, më 22.09. 2022.

VENDIM

Nr.3, datë 14.04.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR  
NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI), TË SUBJEKTIT "AGRO GREEN", ME  
VENDNDODHJE, FSHATI DRASHOVICË, BASHKIA SELENICË, QARKU VLORË



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë "AGRO GREEN", "Kërkesë për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), me vendndodhje, Fshati Drashovicë, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Treguesit paraprak janë si më poshtë  
Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Kuarternar  
Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)  
-X=464948.085; Y=4478333.508; Z=60 m.m.n.d  
Prurja e ujit të kërkuar: Q=1.5 l/sek  
Thellësia e pus-shpimit: 12m  
Diametri pus-shpimit = Ø250mm , thellësia nga 0 deri në 12 m  
Thellësia e vendosjes së pompës : 8m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH) -  
X=464948.085; Y=4478333.508; Z=60 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI**  
**FLAMUR MAMAJ**

